

19 Korrik, 2022



Të Dashur Prindër, Familje dhe Studentë,

Drejtoria Arsimore e Filadelfias është e emocionuar të shpallë Festën e **Dytë Vjetore të Kthimit në Shkollë dhe Turneun me Autobus!** Festimi i kthimit në shkollë të SDP-së vitin e kaluar ishte një sukses i jashtëzakonshëm! Kështu që ne jemi të kënaqur për të vizituar edhe një herë komunitetet e Filadelfias për të ndihmuar familjet të përgatiten për ditën e parë të vitit shkollor 2022-2023 – ditën e Hënë, 29 Gusht.

Turneu mundësohet nga një grant bujar nga “ Independence Blue Cross Foundation” dhe sjell informacione rreth Kthimit në Shkollë dhe shërbime drejt në lagjen tuaj. Nga 1 Gushti deri më 20 Gusht, autobusi do të udhëtojë nëpër Philly duke organizuar dhjetë ngjarje, duke përfshirë katër Mega-Evente emocionuese të bashkë-sponsorizuara nga Radio One, Office Depot, My Philly Lawyer, Countrywide Home Care dhe Eagles Eye Mobile. Në këto ngjarje ju mund të:

- merrni **falas** një çantë dhe pajisje shkollore,
- bisedoni me” Street Team Ambassadors “ për të marrë informacionin që ju nevojitet për të shkuar në shkollë,
- regjistrojeni fëmijën tuaj për Pre K/ deri në klasën e 12-të,
- regjistrohuni për një llogari në Portalin e Prindërve,
- në katër Mega-Events, bëni **falas** imunizimet e fëmijës të nevojshme për të ndjekur shkollën (kërkohet regjistrim paraprak)
- dhe shumë më tepër.

Mund të gjeni programin e plotë të udhëtimit me autobus, përditësimet më të fundit për kthimin në shkollë dhe informacionin e imunizimit në [philasd.org/ringthebell](http://philasd.org/ringthebell) ose duke telefonuar në numrin 215-400-4000. Ne mezi presim t’ju shohim në një nga stacionet e turneut të autobusit dhe mezi presim t’i biem ziles në një vit të ri shkollor.

Shpresojmë t’ju shohim atje!

*Drejtoria Arsimore e Filadelfias*  
*Zyra e Komunikimit*